

1 E enjte, 5 mars 2026

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Thaçi paraqitet përmes

5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 9.30

7 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem,
8 paraqisni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar
10 Gjykatës, kjo është çështja KSC-BC-2023-12, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni
12 Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit.

13 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Për procesverbal vërej që
14 të katër të akuzuarit na ndjekin këtu në sallë, ndërkohë që z.
15 Thaçi na ndjek përmes videolidhjes. Me çfarë kuptoj kërkesa do
16 dërgohet për pak tek Zyra Administrative, apo jo?

17 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës,
18 po, do ndërlidhem me Zyra Administrative dhe me objektin e
19 paraburgimit për të bërë kërkesën përkatëse.

20 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit.

21 A janë të njëjtë përbërës të ekipeve siç ishin dje? Të
22 fillojmë me Prokurorinë.

23 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po, nuk kemi ndryshime.

24 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në rregull. Po e ekipet e
25 Mbrojtjes kanë ndryshime?

1 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Jo, nuk kemi ndryshime.

2 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Shoh që z. Young nuk është
3 këtu. E di ndokush ku është z. Young?

4 Z. REES: [Përkthim] Jo, nuk e di se ku është, megjithatë
5 sa i takon ekipit tonë nuk kemi ndryshim. Nuk mund të shtoj
6 asgjë tjetër, por shikoj që z. Faziu, sigurisht, domethënë, që
7 është i pranishëm këtu.

8 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] A ka ndonjë anëtar të
9 Mbrojtjes së Fazliut të pranishëm këtu në sallë?

10 Përderisa z. Young nuk është këtu, besoj që duhet që ta
11 ndërpresim këtu për momentin sepse duhet që z. Young të jetë i
12 pranishëm në sallë. Në qoftë se ka anëtarë të ekipit të
13 Mbrojtjes që kanë detajet e kontaktit z. Young, do ju kërkoja
14 që të kontaktonit me të dhe çdo informacion që merret, ju
15 lutem, komunikojani Zyrës Administrative.

16 Kështu që, për momentin do e ndërpresim këtu seancën.

17 [Gjykatësi i Vetëm dhe Sekretarja e Gjykatës
18 këshillohen]

19 Pra, edhe një herë, për momentin do e ndërpresim këtu
20 seancën, megjithatë do ju kërkoja që të qëndronit pranë sallës
21 së gjyqit në mënyrë të tillë që të rifillojmë sa më shpejt që
22 të jetë e mundur.

23 --- Seanca ndërpritet në orën 09.33

24 --- Seanca rifillon në orën 10.26

25 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëmëngjes përsëri.

1 A të kalojmë në seancë private, ju lutem.

2 [Seancë private]

3 [Seancë private teksti i fshirë]

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25 [Seancë e hapur]

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës,
2 jemi në seancë të hapur.

3 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] I lutem Sekretares ta
4 sjellë dëshmitarin në sallë.

5 Z. Rees, sa kohë ju duhet me dëshmitarin?

6 Z. REES: [Përkthim] Në rastin më optimist më duhen vetëm
7 20 sekonda.

8 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Kam marrë një email ku
9 thuhet që nuk kanë më pyetje ekipet e tjera të Mbrojtjes, apo
10 jo? Mirë, atëherë, shpresojmë që të na duhen vetëm 20 sekonda.

11 A ka pyetje plotësuese Prokuroria?

12 Z. HAFETZ: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës.

13 Z. REES: [Përkthim] Në qoftë se do shpenzon 21 sekonda, a
14 mund t'i kërkoj Prokurorisë që të mos ankohet që kalova me 1
15 sekondë.

16 Z. HAFETZ: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk ka problem,
17 mund të rrijë i qetë z. Rees.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. Kelly, mirë
20 se keni ardhur.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.

22 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ju kujtoj që jeni nën betim
23 akoma. Do të përfundojmë sot paradite me dëshminë tuaj.

24 Ndoshta do përfundojmë shumë shpejt.

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

1 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Z. Rees, fjala për ju.

2 DËSHMITARI: CHRISTOPHER KELLY [Vijon]

3 Pyetje të palës tjetër nga z. Rees:

4 Z. REES: [Përkthim]

5 PY. Z. Kelly, besoj që e deduktuat nga komentet hapëse të
6 Gjykatës që unë mund të mbaroj në një kohë rekord. Kështu që
7 do bëj një propozim dhe më thoni në qoftë se jeni pajtoheni me
8 të apo jo.

9 Koha e -- ose vula e kohës së fundit në një dosje tregon
10 se kur është hapur për herë të fundit, kur është lexuar ose
11 kur përdoret prej një sistemi operativ, apo jo? A pajtoheni me
12 këtë?

13 PË. Për kë sistem operativ e keni fjalën?

14 PY. Sistemi operativ i Windows në një kompjuter të bartshëm.

15 PË. Këto rregulla ndryshojnë për çdo zbatim ose çdo hap të
16 ndryshëm, domethënë, hapat janë të ndryshme për Windows 10,
17 ose për Windows 11. Në qoftë se keni ndonjë pyetje më
18 specifike mund t'ju jap përgjigjen.

19 PY. Por, si propozim i përgjithshëm, si ide e përgjithshme, a
20 pajtoheni me atë çfarë thashë unë?

21 PË. Po, në përgjithësi pajtohem me atë çfarë thatë ju.

22 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Rees.

23 Z. Kelly, faleminderit për praninë tuaj këtu.

24 Faleminderit për dëshminë e dhënë përpara Gjykatës. Kemi
25 përfunduar tani me dëshminë tuaj. Faleminderit për kohën edhe

1 tani Sekretarja do t'ju nxjerrë nga salla e gjyqit.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

3 [Dëshmitari largohet]

4 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Sikurse e thashë dhe dje,
5 dëshiroj që sot të diskutonim disa çështje plani, planifikimi.

6 Tani do të trajtojmë konkretisht këtë aspekt.

7 Në rregullin 128 [Sipas përkthimit] parashikohet se:

8 "Kur nuk ka më dëshmitarë për të thirrur ose kur nuk
9 duhet që të paraqitet provë tjetër ose dokumente të tjera të
10 çështjes, atëherë Prokurori i Specializuar duhet që të
11 përfundojë me çështjen e vet."

12 Ne e dimë që Prokuroria nuk ka më dëshmitarë për të
13 thirrur tani. Kështu që dua t'i kërkoj Prokurorisë që të thotë
14 në qoftë se ZPS-ja ka prova të tjera për të paraqitur si pjesë
15 e argumenteve të veta.

16 Z. HAFETZ: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, jo, jo tani.

17 Por, thjesht dua të trajtoj një çështje logjistike nëse më
18 lejoni. Kam folur me tre nga ekipet e Mbrojtjes sot, besoj që
19 nuk ka kundërshtim prej këtyre tri ekipeve të Mbrojtjes.

20 Tema e fundit ose dokumenti i fundit që kam diskutuar me
21 Dëshmitarin 9 nuk është pranuar dhe më duket sikur e kam thënë
22 gabim numrin ERN të këtij dokumenti. Kështu që, në qoftë se më
23 lejoni, dhe në qoftë se nuk ka kundërshtim nga palët, kërkoj
24 që ky dokument të pranohet mbështetur në rregullin 136. Flitet
25 për dokumentin e fundit që analizoi dëshmitari. ERN-ja e saktë

1 për këtë dokument është SPOE00366637.

2 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] A ka kundërshtime Mbrojtja?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

4 Z. REES: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

5 Z. EDWARDS: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

6 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

7 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Pra, shikoj që nuk kemi

8 kundërshtim prej Mbrojtjeve, kështu që dokumenti pranohet. Si

9 ta bëjmë klasifikimin si konfidencial?

10 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po, si konfidencial. I falënderoj

11 kolegët për pranimin.

12 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Më lejoni një çast, z.

13 Hafetz, sepse Sekretarja duhet që ta regjistrojë këtë në

14 sistem.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, për

16 procesverbal, dokumenti SPO00366637 do marrë numrin e provës

17 P211, dhe klasifikimi është konfidencial.

18 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Hafetz.

19 Z. HAFETZ: [Përkthim] Për sa i takon pyetjes më të

20 përgjithshme të bërë prej jush, ne nuk planifikojmë që të

21 kërkojmë pranimin e provave të tjera. Megjithëse, sikurse e

22 dini janë provat jogojore shtesë, janë shënimet gjyqësore

23 shtesë, është çështja e Dëshmitarit 8 që dha dëshmi përpara

24 Trupit Gjykues *live*, kemi dhe disa raporte të tjera të cilat

25 ne në këtë fazë nuk parashikojmë që të bëjmë ndonjë kërkesë

1 tjetër shtesë për ekspertin e pavarur. Pra, ne na duhet që të
2 shikojmë raportin përfundimtar të ekspertit të pavarur,
3 megjithatë, nuk planifikojmë që të kërkojmë pranimin e ndonjë
4 dokumenti për momentin lidhur me këtë pikë.

5 Atëherë, ka një çështje tjetër të vogël të nxjerrë nga
6 vulat e kohës, UTC, që janë ngritur si rezultat i punës së
7 ekspertit të pavarur. Kështu që në qoftë se na lejoni
8 dëshirojmë që të komunikojmë përmes mesazheve elektronike për
9 të sqaruar një aspekt të mbuluar në ekspertin e pavarur -- në
10 raportin e saj, dhe do kopjojmë edhe Mbrojtjet në mënyrë të
11 tillë që të marrim shpjegimet dhe sqarimet e duhura. Përveç
12 kësaj nuk parashikoj asgjë tjetër. Nuk kemi tjetër gjë për të
13 shtuar.

14 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po, ka disa aspekte të
15 provave shkresore të cilat duhet të vendosen. Domethënë, është
16 çështja e Dëshmitarit 8 që do të duhet të vendoset dhe dua të
17 them që synoj që të nxjerr një vendim lidhur me këtë aspekt
18 deri me 19 mars 2026. Sikurse e përmendët kemi gjithashtu edhe
19 kërkesën e Smakajt për të cilën nuk është marrë ende një
20 vendim për redaktimin e një transkripti, që është parashtrimi
21 747. Pastaj kemi provat jogojore shtesë që është parashtrimi
22 754. Dhe parashtrimi 769 dhe 773 që kanë të bëjnë me njohjen
23 dhe pranimin e fakteve shtesë dhe të njohurisë së zakonshme.

24 Pra, a ju kuptova drejtë, z. Hafetz, që ju thoni që
25 përtej këtyre dëshmive, provave, dokumenteve që unë sapo i

1 përmenda, nuk kemi asgjë tjetër për të shtuar përveç raportit
2 të fundit të ekspertes së pavarur? Këtë po thoni, apo jo,
3 Prokuror?

4 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po, ekzaktësisht kështu.

5 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Tani dua t'i drejtohem
6 ekipeve të Mbrojtjes për të më thënë në qoftë se keni ndonjë
7 koment lidhur me këtë parashtrim konkret të Prokurorit. Në
8 qoftë se nuk kemi parashtrim, nuk ka problem.

9 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Për procesverbal dua të them se
10 ZPS-ja nuk mund të thotë që e mbyll çështjen e vet dhe të
11 thotë që mund të kërkojë pranimin apo jo të ekspertes së
12 pavarur, domethënë, duhet ta ketë ndarë mendjen e vet kur të
13 thotë që e ka mbyllur çështjen, dhe data përfundimtare e
14 mbylljes së çështjes ose të argumenteve të Prokurorisë kur
15 Prokuroria nuk ka asnjë kërkesë tjetër për sa i takon pranimin
16 të dokumenteve ose aspekteve të tjera që kanë të bëjnë me
17 argumentet e veta.

18 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit, z. Menegon,
19 për komentet tuaja.

20 Tani duke e lënë mënjanë çështjen ose aspektin e datës së
21 mbylljes së argumeteve të Prokurorisë, dhe dua t'ju kujtoj të
22 gjithëve që data që kam vendosur është data 12 mars,
23 megjithatë, kjo është datë e synuar nuk është datë
24 përfundimtare. Kështu që tani do të mundohem që t'i kërkoj
25 Mbrojtjes që të më japë ndonjë ide, në qoftë se ka ndonjë ide

1 lidhur me atë çfarë do të ndodhë pasi të përfundojë argumentet
2 e veta Prokuroria.

3 Atëherë, dua t'ju pyes në qoftë se në këtë fazë Mbrojtja
4 do ketë -- do dorëzojë ndonjë mocion të vetin apo jo, dhe dua
5 të them që ky është mocioni që nuk kërkohet sipas rregullës
6 130 derisa të përfundojë argumentet e veta Prokuroria dhe e
7 kuptoj që varet edhe nga disa aspekte të tjera që janë pezull
8 për të cilat nuk janë marrë vendime, e kam fjalën këtu për
9 provat që nuk janë vendosur akoma nëse pranohen apo jo.

10 Kështu dua t'ju pyes ekipeve të Mbrojtjes në qoftë se
11 keni planifikuar apo jo që të dorëzoni një mocion apo jo sipas
12 rregullave përkatëse të procedurës.

13 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Sikurse e thatë me të drejtë e
14 rezervojmë pozicionin tonë në këtë fazë, ka pak të ngjarë të
15 dorëzojmë një mocion.

16 Z. REES: [Përkthim] Nuk mund të shprehem për momentin.

17 Z. EDWARDS: [Përkthim] Në këtë fazë ka pak të ngjarë që
18 ne të bëjmë një dorëzim të mocionit.

19 Z. YOUNG: [Përkthim] E njëjta gjë vlen edhe për neve.

20 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Edhe për neve e njëjta gjë vlen.

21 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Në aspekte të përgjithshme,
22 dhe sigurisht që e kuptoj që Mbrojtjes nuk i duhet që të japë
23 ndonjë gjë konkretisht, apo të na japë të dhëna konkrete tani
24 në këtë moment. Megjithëse, dëshiroj që t'i pyes ekipet e
25 Mbrojtjes të më thonë në qoftë se ato janë në gjendje që të më

1 thonë nëse do kenë argumentet e veta të parashtruara, në qoftë
2 se planifikojnë që të bëjnë, të parashtrojnë argumentet e
3 veta.

4 Qëndrimin e Mbrojtjes së Smakajt e kam të qartë,
5 megjithatë, dua të pyes ekipet e tjera të Mbrojtjes në qoftë
6 se ka ndonjë përgjigje për pyetjen time.

7 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Qëndrimi ynë nuk është definitiv
8 ende, megjithëse, në këtë fazë ka të ngjarë që të kemi
9 argumentet tona. Faleminderit.

10 Z. EDWARDS: [Përkthim] Po, po, edhe në rastin tonë.

11 Z. YOUNG: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, qëndrimi është
12 që në qoftë se do kemi argumentet tona, argumentet do jenë
13 shumë të shkurtra dhe ne do t'i bëjmë kërkesë Trupit Gjykses,
14 domethënë juve, që të jepen dëshmitë përmes videolidhjes,
15 domethënë, nga persona të cilët janë në Prishtinë. E kuptojmë
16 që kemi afat 21-ditor, do ta bëjmë sipas afateve konkrete
17 kërkesën.

18 Z. ADMIRAAL: [Përkthim] Në këtë fazë nuk ka të ngjarë që
19 të kemi argumentet tona.

20 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Sigurisht duke marrë
21 parasysh aspekte të ndryshme ose rrethanat, pra, do bëj
22 pyetjen dhe pastaj do ju kërkoj që të konsultoheni ndërmjet
23 jush. Do bëjmë një pushim pastaj duhet të vini me një
24 përgjigje. Pra, dua t'ju pyes në qoftë se tri javë kohë
25 gjykate do ishin të mjaftueshme për të dëgjuar të gjitha

1 argumentet tuaja të të gjithë dëshmitarëve që mund të keni. Si
2 e mendoni? Pra, nuk do ju kërkoj që të më jepni një përgjigje
3 tani, sepse kjo do ju kërkonte që të konsultoheshit këtu në
4 sallën e gjyqit dhe mund të bëhej pak zhurmë edhe do ishte e
5 parakohshme, por pyetja që kam dhe që ju duhet ta mendoni, ta
6 shtjelloni ndërmjet jush është që nëse tre javë në sallën e
7 gjyqit janë të mjaftueshme, dhe ju kërkoj që pasi të jeni
8 konsultuar në pushim me njëri-tjetrin të vini me një
9 përgjigje.

10 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Përderisa ju e thatë dje që ju
11 planifikoni që të na pyesni neve për sa i takon kalendarit,
12 ne e kemi diskutuar pjesën e kalendarit, pra, sipas nesh dhe
13 sipas të gjitha ekipeve të Mbrojtjes tre javë janë të
14 mjaftueshme, megjithëse ende nuk e kemi përfundimtar qëndrimin
15 tonë.

16 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po dy javë, dy javë
17 mjaftojnë, apo jo?

18 ZNJ. MENEGON: [Përkthim] Këtë nuk ja u them dot.

19 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Faleminderit. E drejtë.

20 Mirë, atëherë, në këtë fazë besoj që ishte mirë që të
21 kishim një përditësim, përditësimin e kemi marrë si me gojë
22 ashtu edhe në të shkruar gjatë seancës përgatitore të gjykimit
23 përpara sesa të fillonte procesi gjyqësor, por, tani që
24 reflektoj, besoj që do ishte më mirë që t'ju kërkoja të gjithë
25 juve, domethënë, të gjitha ekipet e Mbrojtjes që të

1 përditësonit në trajtë të shkruar, përfshirë këtu edhe përmes
2 postës elektronike dhe të më thoni se cilat janë datat për të
3 cilat do të ishit të disponueshëm për seancë gjyqësore, për
4 shembull, le të prezumojmë që do planifikojmë tre javë për
5 dëshmitarët e Mbrojtjes.

6 Duhet të më thoni se kur jeni të disponueshëm. Pra, kjo
7 është një përgjigje që do të duhet të më jepet prej secilave
8 prej ekipeve të Mbrojtjes.

9 Z. Hafetz, mendoj që ZPS-ja është e disponueshme gjatë të
10 gjithë kohës, apo jo?

11 Z. HAFETZ: [Përkthim] Po, ne jemi të disponueshëm në çdo
12 moment.

13 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit shumë që na kërkuat që
14 të themi që kur jemi të disponueshëm për gjyq, e vlerësojmë
15 shumë.

16 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] A ka ndonjë aspekt tjetër
17 që dëshironi të ngrini sa i takon kalendarit ose sa i takon
18 planifikimit?

19 Z. EDWARDS: [Përkthim] Jo, vetëm diçka kam. Dua që të
20 theksoj dhe një herë falënderimet që ju tha z. Rees.
21 Faleminderit që jeni i disponueshëm që të merrni parasysht
22 kohën kur mund të vijmë ne në Gjykatë. Kam një pyetje që mbase
23 është pak e komplikuar, por pyetja është kjo: A ka mundësi
24 Gjykata në aspekte të përgjithshme, në vija të përgjithshme,
25 të na thotë se çfarë periudhe keni parasysht ju, domethënë, nga

1 tani deri në momentin kur do hapen argumentet e Mbrojtjes, kur
2 të thërrasë dëshmitarët e vet Mbrojtja? Domethënë, thjesht në
3 vija të përgjithshme për të pasur një ide, sepse në qoftë se
4 na jepni informacionin e përgjithshëm pastaj mund të na
5 ndihmoni më tepër ne për t'ju thënë që kur jemi të
6 disponueshëm.

7 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Nuk mund të them që e kam
8 konsultuar kalendarin që është miratuar në Çështjen 07,
9 domethënë, që ka një lloj vlere precedenti sa i takon
10 madhësisë së çështjes, dhe sa i takon faktit se si është
11 trajtuar periudha ndërmjet dëshmitarëve të Prokurorisë dhe
12 dëshmitarëve të Mbrojtjes.

13 Unë mund t'ju them që nuk do jemi aq të shpejtë sa ka
14 qenë Trupi Gjykses në Çështjen 7. Por, edhe një herë dua të
15 them që jam i hapur që të marr disponueshmërinë tuaj si ekipe
16 Mbrojtje dhe do ta marr parasysh atë çfarë do më thoni ju.
17 Megjithatë, në një botë ideale mund të them që Gjykata
18 shpreson që të ketë mundësi të fillojë përpara fundit të
19 prillit.

20 Z. EDWARDS: [Përkthim] Atëherë unë flas në emër të
21 Mbrojtjes së Kilajt, për ne kjo na ndihmon shumë. Ju
22 falënderoj.

23 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka disa aspekte të tjera,
24 një aspekt në veçanti që e ka dorëzuar Mbrojtja e Fazliut në
25 kërkesën e vet dje - për të cilën do të duhet të marr vendim.

1 Kështu që do bëjmë një pushim për 15 minuta tani dhe do
2 kthehemi pas pushimit dhe pas pushimit do lexoj të paktën një
3 urdhër gojor, të paktën. Kështu që ju kërkoj të bëni pushim 15
4 minuta e do kthehemi përsëri në sallë.

5 --- Seanca ndërpritet në orën 10.45

6 --- Seanca rifillon në orën 11.01

7 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirë se u kthyet.

8 Tani do të caktoj disa afate që lidhen me periudhën para
9 fillimit të provave prej Mbrojtjes dhe hapat që duhet të
10 ndërmarrim që të sigurojmë mbylljen e provave të Prokurorisë
11 edhe çfarë do bëhet në qoftë se do të ketë -- nuk do të ketë
12 mocion për rrëzimin e akuzave nga Mbrojtja.

13 Ky është urdhër dhe në këtë urdhër do të jap afatet si në
14 vijim në lidhje me këto aspekte.

15 Mbrojtësja e pavarur do të dorëzojë raportin e fundit
16 deri më 13 mars 2026.

17 ZPS-ja duhet të përgjigjet ose më saktë të dorëzojë çdo
18 mocion që lidhet me çështjet që janë ngritur në atë raport si
19 dhe njoftimin sipas rregullës 129 deri më 18 mars 2026.

20 Mbrojtja duhet të dorëzojë parashtrimet sipas rregullës
21 130 brenda 19 marsit 2026.

22 Çdo mocion tjetër në mbështetje të kësaj kërkesë apo
23 parashtrime në mbështetje të kësaj kërkesë duhen të dorëzohen
24 brenda 25 marsit 2026. Përgjigjet duhet të dorëzohen brenda 1
25 prillit 2026.

1 Me kaq mbyll urdhrin e parë me gojë.

2 Kam dhe një çështje tjetër shumë të rëndësishme, që është
3 kërkesa e z. Fazliu për ndryshimin e kushteve të lirimimit me
4 kusht. Kërkesa mban parashtrimin 720.

5 Ky është urdhër me gojë.

6 Ose mund të ketë dhe disa aspekte që mbase duhet t'i
7 trajtoj në seancë private, kështu që për të qenë të sigurt
8 kalojmë në seancë private.

9 [Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14 [Seancë e hapur]

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë të
16 hapur.

17 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka ndonjë parashtrim prej
18 palëve përpara se ta mbyllim seancën e sotme.

19 Z. HAFETZ: [Përkthim] Shumë shkurt dua të diskutoj lidhur
20 me afatet. Për çështjen e vulave kohore që duam të sqarojmë, a
21 duhet të bëjmë -- duhet të na dërgoni një kërkesë *inter*
22 *partes*?

23 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Po, mund të bëni një
24 kërkesë *inter partes*.

25 Z. Edwards.

1 Z. EDWARDS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a e dini se
2 kur mund të lëshohet një urdhër në bazë të rregullës 119 për
3 provat e Mbrojtjes dhe konferenca përgatitore për Mbrojtjen?
4 Nëse do të nxirrni urdhër sipas rregullës 119, a do të ketë
5 konferencë përgatitore për Mbrojtje brenda shtatë ditësh pas
6 këtij urdhri? Me përfaqësi mund të na thoni se kur mund të
7 lëshohet ky urdhër, në mënyrë që të organizojmë axhendën tonë,
8 vetëm për këtë pyesim.

9 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Fatkeqësisht duke qenë se
10 unë nuk e di se çfarë do bëni ju me mocionin 130 edhe nuk e
11 dimë ende kur mund të fillojë Mbrojtja me dëshmitarët e vet,
12 nuk jam në pozicion aktualisht t'jua jap afatin për këtë.

13 Sidoqoftë, unë do propozoja që palët ta ndjekin këtë
14 konferencë edhe përmes videolidhjes nëse nuk janë këtu
15 fizikisht që ta realizojmë edhe ta bëjmë të mundur paraqitjen
16 e tyre, pjesëmarrjen e tyre në seancën përgatitore.

17 Z. EDWARDS: [Përkthim] Faleminderit.

18 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Ka gjë tjetër?

19 Z. REES: [Përkthim] Jo.

20 GJYKATËSI GOSNELL: [Përkthim] Mirë, faleminderit atëherë.

21 Seanca mbyllet këtu.

22 --- Seanca mbyllet në orën 11.11

23

24

25